

POLITIKA E PRIVATËSISË e Makedonski Telekom SHA - Shkup

1. Informacione të përgjithshme për Kontrolluesin e të dhënave personale dhe Oficerin e të dhënave personale

Kontrollues: Makedonski Telekom SHA Shkup, Shoqëria Aksionare për komunikime elektronike – Shkup
(në tekstin e mëtejme Makedonski Telekom, MKT)

Selia: Kej 13-të Nëntori nr.6, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Oficeri për mbrojtjen e të dhënave personale në MKT:

Makedonski Telekom, në përputhje me ligjin, e ka emëruar një person - oficer për mbrojtjen e të dhënave personale i cili është i autorizuar të veprojë në aktivitetet dhe procedurat që kanë të bëjnë me përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Oficerin për mbrojtjen e të dhënave personale të MKT-së mund ta kontaktoni përmes kanaleve të mëposhtme të komunikimit:

E-mail adresa elektronike: dpo@telekom.mk

Telefoni: 02/ 3242-763

2. Vëllimi dhe përmbajtja e kësaj Politike

Në këtë Politikë mund të gjeni informacione lidhur me grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave personale nga personat fizikë – subjekte të të dhënave personale të cilat i grumbullon, ruan dhe përpunon Makedonski Telekom SHA Shkup edhe atë:

- Parime për përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale
- Kategoritë e të dhënave personale të cilat MKT i përpunon;
- Qëllimet për të cilat bëhet përpunimi i të dhënave personale,
- Baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale;
- Shfrytëzuesit apo kategoritë e abonuesve të të dhënave personale;
- Transferimi i të dhënave personale në vendet e treta, nëse ekziston;
- Sa gjatë i ruajmë të dhënat tuaja personale;
- Të drejtat e abonuesve si subjekte të të dhënave personale i keni gjatë përpunimit të të dhënave personale.

3. Cila është qasja e jonë ndaj të dhënave personale të abonuesve tanë?

Makedonski Telekom (MKT) si kontrollues i të dhënave personale, i kushton rëndësi të madhe respektimit të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale. MKT i përpunon të dhënat personale që i merr nga subjektet e të dhënave personale. Për të qenë një kontrollues i besueshëm i të dhënave personale, ne i kushtojmë vëmendje të veçantë mbrojtjes së të dhënave personale në çdo segment të proceseve të biznesit përmes zbatimit të standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare për mbrojtjen e të dhënave personale.

MKT angazhohet të sigurojë mbrojtjen e të dhënave tuaja personale në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale (në tekstin e mëtejme: LMDHP), aktet nënligjore të Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave personale, aktet e brendshme të MKT-së me ç'rast gjatë punës së vet i zbaton udhëzimet dhe standardet e Grupacionit Dojçe Telekom të cilat bazohen në kuadrin rregullator evropian përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale (GDPR).

4. Parime për përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale

Të punësuarit dhe personat e angazhuar të cilët kryejnë përpunimin e të dhënave personale në MKT, e kanë për obligim t'i respektojnë parimet për mbrojtjen e të dhënave personale, edhe atë:

4.1. Mënyrë ligjore, korrekte dhe transparente e përpunimit të të dhënave personale

Të dhënat personale mbledhen dhe përpunohen ekskluzivisht për qëllimet e përcaktuara në ligjin përkatës, përmbushjen e lëndës së kontratës së lidhur me MKT-në dhe pagesën e shërbimeve të kryera ose të produkteve të blera, bazuar në pëlqimin e marrë për përpunimin e të dhënave personale nga përdoruesi për qëllimet e specifikuar aty (p.sh. Marketingu i drejtpërdrejtë) si dhe kur ka një interes legjitim.

4.2. Kufizimi i qëllimit të përpunimit të të dhënave personale

MKT i përpunon të dhënat personale vetëm për qëllime që janë të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore, përmbushjen e të drejtave dhe detyrimeve nga kontrata e lidhur, pagesën e kërkesave të saj dhe përpunimin për qëllime për të cilat përdoruesi ka dhënë pëlqimin paraprak. Nëse MKT ka një interes legjitim në përpunimin e të dhënave personale për qëllime të tjera, një përpunim i tillë do t'i nënshtrohet analizës dhe vlerësimit të ndikimit të një përpunimi të tillë mbi privatësinë e abonuesve.

4.3. Kufizimi i vëllimit të të dhënave personale

Përpunimi i të dhënave personale kufizohet vetëm në ato të dhëna që janë të nevojshme për të përmbushur qëllimin e përpunimit.

Nëse ka nevojë për të përpunuar të dhëna shtesë, MKT do ta informojë përdoruesin si subjekt i të dhënave personale për paraqitjen e të dhënave shtesë dhe, kur është e nevojshme, do të kërkojë pëlqimin e tij për atë përpunim shtesë.

4.4. Saktësia e të dhënave personale

Dhënia e të dhënave reale, të sakta dhe të plota, si dhe njoftimi në kohë i ndryshimeve të të dhënave personale, është detyrim ligjor dhe kontraktual i abonuesve dhe i njëjti është kusht i domosdoshëm për krijimin e një marrëdhënie abonimi, si dhe për përmbushjen e të drejtave dhe detyrimeve që dalin nga marrëveshja parapaguese.

MKT ka detyrim ligjor të mbajë shënime të sakta të abonuesve të saj dhe për këtë qëllim, zbaton masa të arsyeshme për të konfirmuar saktësinë, korrigjimin dhe/ose fshirjen e të dhënave personale të pasakta ose të paplota. Përveç masave të marra nga MKT, çdo abonues ka të drejtë të kërkojë korrigjimin, ndryshimin ose fshirjen e të dhënave të tij personale në një mënyrë të thjeshtë dhe të lehtë siç përcaktohet në pikën 10 të kësaj Politike.

4.5. Kufizimi i afateve të përpunimit të të dhënave personale

Të dhënat personale të marra nga abonuesit në bazë të lidhjes së kontratës parapaguese ose me aktivizimin e një shërbimi të komunikimit elektronik nga një person i caktuar për të cilin nuk është parashikuar lidhja e kontratës parapaguese (për shërbime pripejd) MKT i ruan në përputhje me afatet e përcaktuara në ligjin përkatës (p.sh. Ligjin për komunikimet elektronike).

Pas skadimit të afateve ose pas përmbushjes së qëllimit të përpunimit, të dhënat personale fshihen nga sistemi i regjistrimit të MKT.

MKT mund të përpunojë të dhëna për qëllime statistikore ose të tjera afariste dhe në afat më të gjatë, sipas nevojave të veta, por me këtë rast, këto të dhëna janë anonime, pas së cilës këto të dhëna nuk mund të lidhen me një subjekt specifik të të dhënave personale dhe nuk përmbajnë asnjë të dhënë personale.

4.6. Integriteti dhe besueshmëria e të dhënave personale

MKT merr masa të duhura teknike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat personale nga qasja e paautorizuar, zbulimi i paligjshëm, ndryshimi ose shkatërrimi i të dhënave. Qasja në të dhënat personale është e kufizuar për personat që janë të autorizuar të përpunojnë të dhënat personale në përputhje me përshkrimin e detyrave të punës dhe për aktivitetet e kërkuara për zbatimin e detyrimeve ligjore, përmbushjen e kontratës, përpunimin në bazë të pëlqimit të dhënë ose përmbushjen e interesit legjitim.

4.7. Llogaridhënia

MKT në pajtim me parimin e llogaridhënies të përcaktuar në LMDHP disponon me regjistrime dhe dëshmi se janë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e parimeve të dhëna më lartë në praktikë, gjegjësisht i përmbush kërkesat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Kategori të të dhënave personale që janë lëndë e përpunimit

MKT i grumbullon, ruan dhe përpunon të dhënat personale të cilat janë të përcaktuara me ligj si edhe të dhënat e nevojshme për përmbushjen e lëndës së marrëveshjes së kontraktuar me MKT (p.sh. Sigurimin e shërbimit për të cilin është kontraktuar kontrata parapaguese dhe pagesa e shërbimeve të shfrytëzuara).

5.1. Të dhëna personale për identifikimin e subjektit

- emri dhe mbiemri,
- adresa e vendbanimit (duke e përfshirë edhe adresën për instalimin e pajisjes dhe adresën për dorëzimin e produkteve/faturave mujore, nëse janë të ndryshme nga adresa e vendbanimit),
- numri i vetëm amëz i abonuesit (NVAQ),
- informacione për kontakt (posta elektronike, numri i telefonit)
- profesioni

Vërejtje: MKT nuk mbledh ose përpunon kategori të veçanta të të dhënave personale si të dhëna për origjinën racore ose etnike, pikëpamjet politike, bindjet fetare ose filozofike ose anëtarësimin në sindikata, si dhe të dhëna gjenetike, të dhëna biometrike, të dhëna në lidhje me shëndetin ose të dhëna në lidhje me jetën seksuale apo orientimin seksual të personit fizik;

5.2 Të dhëna shtesë të nevojshme për kontraktimin dhe plotësimin e marrëveshjes

Këto të dhëna personale MKT i merr nga subjektet e të dhënave personale për nevojat e kontraktimit të marrëveshjes ose gjatë vlefshmërisë së kontratës së dakorduar dhe i përpunon për qëllime të përcaktuara saktë siç janë:

- të dhëna për verifikimin e aftësisë pagesore (siç janë të dhënat për marrëdhënie pune ose të drejtë të realizuar të pensionit, të dhëna të marra nga Byroja Kreditore e Maqedonisë në bazë të pëlqimit paraprak, historisë pagesore të faturave në MKT)
- të dhëna për pagesën e kryer (fatura transaksionare, të dhëna nga kartela pagesore të cilën subjekti në mënyrë vullnetare e ka incizuar në aplikacionin përkatës për pagesë etj.)

5.3. Të dhëna për komunikacionin e realizuar:

Ky lloj i të dhënave përpunohet gjatë përdorimit të shërbimeve komunikuese elektronike nga MKT për shkak mundësimin dhe bartjes së komunikimit të lidhur dhe pagesës së shërbimeve të realizuara.

Këtu bëjnë pjesë edhe llojet e radhës të të dhënave:

- të dhëna të nevojshme për ndjekjen dhe identifikimin e burimit të komunikimit;
- të dhëna të nevojshme për identifikimin e destinacionit të komunikacionit;
- të dhëna të nevojshme për identifikimin e datës, orës dhe kohëzgjatjes së komunikimit;
- të dhëna të nevojshme për identifikimin e llojit të komunikimit;
- të dhëna të nevojshme për identifikimin e pajisjes komunikuese përmes së cilës është realizuar komunikimi;
- të dhëna për përcaktimin e lokacionit të pajisjes komunikuese mobile
- të dhëna për komunikacionin e realizuar përmes rrjetit publik elektronik si psh. kohëzgjatja e thirrjes, numri i SMS mesazheve, numri i thirrjeve të realizuara, sasia e komunikacionit të internetit dhe numri i sesioneve të realizuara të internetit etj.

Vërejtje: MKT nuk grumbullon, ruan dhe as përpunon të dhëna lidhur me përmbajtjen e komunikimit të realizuar, që në pajtim me ligjin është i besueshëm dhe i fshehtë. Mbikëqyrje të përmbajtjes së komunikimeve mund të bëjë vetëm një organ shtetëror kompetent në procedurën e paraparë me ligj;

6. Qëllime gjatë përpunimit të të dhënave personale

6.1. Verifikimi i aftësisë pagesore

Përpara kontraktimit të kontratës me një person që nuk është abonues ose shfrytëzues, MKT mund të përpunojë të dhënat personale duke marrë një raport nga subjektet e autorizuar që përpunojnë të dhëna për qëllime të përcaktimit të aftësisë kreditore (Byroja Kreditore e Maqedonisë) për të përcaktuar aftësinë pagesore të këtij personi dhe llojin e shërbimeve që mund t'i ofrohen këtij abonuesi. MKT e kryen një kontroll të tillë në bazë të pëlqimit të duhur të marrë nga subjekti i të dhënave personale. Gjithashtu, gjatë kontrollit të aftësisë pagesore, MKT mund të kërkojë gjithashtu paraqitjen e një vërtetimi punësimi ose një dokumenti për përcaktuar ekzistencën e statusit të pensionistit nga personi konkret që dëshiron të lidhë një kontratë të re për përdorimin e shërbimeve dhe/ose furnizimin e produkteve me MKT ose në rast të një përdoruesi ekzistues, t'i përdorë të dhënat që i disponon MKT për përcaktimin e aftësisë pagesore dhe pagesën në kohë të faturave mujore ndaj MKT-së.

Nëse bëhet fjalë për abonues ekzistues të shërbimeve të MKT-së, para lidhjes së kontratës, MKT mund të përpunojë të dhënat që disponon në regjistrat e saj në lidhje me përcaktimin e aftësisë pagesore të tij, nëse këto të dhëna ruhen ende sipas afateve të përcaktuara në rregulloret përkatëse.

Në rastin e një aftësie pagesore të ulët të përcaktuar që nuk ofron garanci për pagesën në kohë dhe të plotë të faturave mujore, MKT mund të rekomandojë përdorimin e shërbimeve bazuar në parimin e pagesës paraprake (gjegjësisht Shërbimet pripejd) ose një model tjetër tarifar të përshtatshëm me aftësinë pagesore të subjektit të të dhënave personale.

6.2. Krijimi i një marrëdhënie abonimi dhe realizimi i kontratës

Për shkak të përmbushjes së lëndës së marrëveshjes së lidhur me subjektin e të dhënave personale, MKT i përpunon të dhënat personale dhe/apo të dhënat për komunikacionin e realizuar të komunikimit për qëllimet në vijim:

- Instalimin/intervenimin në kyçjen apo pajisjen për sigurimin e shërbimit për shkak të dorëzimit të produktit
- Sigurimin, gjegjësisht përdorimin e shërbimeve të dakorduara elektronike komunikuese
- Përgjigje për një ankesë të shtruar nga abonuesi për lartësinë e faturës apo cilësinë e shërbimeve
- Sigurimi i shërbimeve të mbështetjes abonuese, gjegjësisht kujdesin për abonuesit dhe matjen e kënaqësisë së abonuesve
- Përmbushja e obligimeve nga garancia e dhënë për një produkt të blerë
- Pagesa e borxhit në pajtim me faturat mujore për shërbimet e shfrytëzuara

- Njoftime të cilat MKT i dorëzon deri tek abonuesit lidhur me përdorimin e shërbimeve (për shembull, njoftimin për përdorimin e rritur të shërbimeve, dërgimin e përkujtuesve për pagesën e shërbimeve, njoftimin se abonuesi është në roaming, etj.)

6.3 Aktivitete parandaluese për mbrojtje nga dëme dhe mashtrime

MKT i përpunon të dhënat personale të abonuesve dhe të dhënat për komunikacionin e realizuar që të mbrohet vet dhe abonuesit e vet nga krijimi i dëmeve apo parandalimin e mashtrimeve të cilat kanë të bëjnë me:

- Keqpërdorimin e të dhënave të huaja personale
- Keqpërdorimin e shërbimeve apo qasjen e dhënë në rrjetin e komunikimit të MKT për qëllime të cilat janë në kundërshtim me kontratën e dakorduar
- Mbrojtjen e abonuesve nga vëllimi i madh dhe jotipik i komunikacionit

6.4 Dorëzimi i informacioneve deri tek organet e autorizuar

MKT i përpunon të dhënat personale të abonuesve dhe të dhënat për komunikacionin e realizuar për dhënien e informacionit me kërkesë të organeve shtetërore në kuadër të kompetencave të tyre të dhëna me ligj, si p.sh. Gjykata, Prokuroria Publike, agjencitë shtetërore (AKE, ISHT, etj.) ose për t'u dhënë informacion personave me kompetenca publike (avokatë, noterë, përmbaues) lidhur me zhvillimin e një procedure të përshtatshme ligjore për mbledhjen e borxhit.

6.5. Përpunimi i të dhënave personale në bazë të pëlqimit të marrë

Nëse përpunimi nuk bëhet për nevojat e përmbushjes së detyrimeve ligjore ose përmbushjes së marrëveshjes, MKT mund ta bëjë përpunimin e të dhënave personale në bazë të pëlqimit të subjektit përkatës të të dhënave personale.

Ky përpunim bëhet për përmbushjen e qëllimeve për të cilat është dhënë pëlqimi i tillë, siç janë aktivitetet vijuese:

- ✓ Marketingu i drejtpërdrejtë

Në bazë të këtij pëlqimi, MKT përpunon të dhënat personale (emrin, mbiemrin, adresën, e-mail adresën, numrin e telefonit dhe të dhënat për komunikacionin e komunikimeve dhe mënyrën e përdorimit të shërbimeve) për dërgimin e përmbajtjeve reklamuese, promociioneve, ofertave të produkteve dhe shërbimeve nga oferta aktuale e MKT-së, ku për përmbushjen e këtij qëllimi, MKT kryen edhe përpunimin automatik të të dhënave lidhur me një përdorues të caktuar, pra profilizimin e të dhënave si modeli tarifar që ai e përdor, sjelljen e tij gjatë përdorimit të shërbimeve në lidhje me mënyrat e përdorimit të shërbimeve të caktuara të komunikimit, vëllimin e shërbimeve të përdorura etj. Profilimi lidhur me marketingun e drejtpërdrejtë MKT e kryen që të mundet abonuesit t'i ofrojë shërbim, paketë shtesë ose model tarifar që do të jenë relevante për të, gjegjësisht do t'u përgjigjen nevojave të tij abonuese, mënyrës dhe vëllimit të përdorimit të llojeve të caktuara të shërbimeve që i siguron MKT dhe do t'i mundësojë shfrytëzimin optimal të shërbimeve dhe përmbushjen e nevojave të tij. Për shembull, nëse abonuesi e shfrytëzon vëllimin e paraparë të komunikacionit të internetit të përfshirë në tarifën e tij, MKT mund t'i ofrojë tarifë me vëllim më të madh të komunikacionit të internetit apo paketë plotësuese interneti me të cilën do të mund të vazhdojë t'i përdorë shërbimet për bartjen e të dhënave gjegjësisht internetin.

Pëlqimi për marketing të drejtpërdrejtë është i paobligueshëm dhe abonuesi ka të drejtë ta tërheqë atë në çdo kohë, në mënyrë të thjeshtë dhe falas, siç është dhënë më poshtë në Nenin 6.6.

- ✓ Libri i numrave publikë

Mbi bazën e këtij pëlqimi, MKT i përpunon të dhënat personale të përdoruesit - person fizik (emri dhe mbiemri, adresa e vendbanimit), së bashku me numrin e tij parapagues duke i publikuar të njëjtat në Librin e numrave publikë, për t'i bërë të dhënat e atij abonuesi të disponueshme publikisht në mënyrë që të mund të kontaktohet.

Pëlqimi për librin e numrave publikë është i paobligueshëm dhe abonuesi ka të drejtë ta tërheqë atë në çdo kohë, në një mënyrë të thjeshtë dhe falas, siç është dhënë më poshtë.

✓ Verifikimi i aftësisë pagesore përmes Byrosë Kreditore të Maqedonisë

Mbi bazën e këtij pëlqimi, MKT i përpunon të dhënat personale të abonuesit - person fizik (emri dhe mbiemri, adresa e banimit dhe NVAQ) për të marrë një raport për aftësinë pagesore të tij nga Byroja Kreditore e Maqedonisë - shoqëri aksionare e cila, sipas ligjit, është e autorizuar të mbledhë dhe përpunojë të dhëna për borxhet dhe rregullsinë në shlyerjen e detyrimeve të personave fizikë dhe juridikë.

MKT i përdorë të dhënat e tilla për të vlerësuar aftësinë pagesore dhe ekspozimin kreditor të një përdoruesi specifik kur lidh një kontratë të re, aktivizon një shërbim të ri ose blen një produkt specifik, dhe bazuar në këto të dhëna mund t'i ofrojë përdoruesit një mënyrë alternative për të përdorur shërbimet nga MKT ose të refuzojë shitjen me këste të një produkti të caktuar, siç shpjegohet në nenin 6.1.

6.6 Kanale për ofrimin dhe tërheqjen e pëlqimeve

Ofrimi dhe tërheqja e pëlqimeve nga një abonuesi i mëvetësishëm mund të bëhet në disa mënyra edhe atë:

- Gjatë kontraktimit të kontratës abonuese, abonuesi prononcohet për përzgjedhjen e vet për pëlqimet e kërkuara dhe i njëjti futet në sistemin e evidentimit të MKT-së, me ç'rast vlerat e përzgjedhura (po ose jo) me një përshkrim përkatës në çdo pëlqim janë dhënë me shtojcë të veçantë ndaj marrëveshjes.
- Në çdo kohë pas kontraktimit të kontratës abonuesi mund të bëjë ndryshim, gjegjësisht të japë ose tërheqë ndonjë pëlqim të caktuar përmes njërit prej kanaleve vijuese:
 - 1) Përmes paralajmërimit dhe verifikimit të abonuesit të një moduli të veçantë në faqen e internetit të MKT-së – telekom.mk deri tek e cila mund të qaseni edhe përmes aplikacionit Telekom i m, ku vetë abonuesi mund t'i bëjë ndryshimet në pëlqimet sipas përzgjedhjes së tij;
 - 2) Përmes dorëzimit të një formulari të veçantë në formë të shkruar të publikuar në faqen e internetit të MKT-së në sallonin më të afërt të shitjes ose në e-adresën dp@telekom.mk;
 - 3) Duke u paraqitur në Qendrën për kontakt të MKT-së në numrin e telefonit 122.

6.7 Përpunimi automatik i të dhënave të abonuesve – profilimi pa pëlqim shtesë

Profilim është çdo formë e përpunimit automatik të të dhënave personale me qëllim të vlerësimit të disa aspekteve personale, preferencave dhe interesave të një subjekti të caktuar të të dhënave personale.

Përveç përpunimit automatik të të dhënave të abonuesit për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë që MKT e bën në bazë të pëlqimit të abonuesit, siç përshkruhet më sipër, në raste të caktuara përpunimi i të dhënave personale nëpërmjet profilimit që MKT bën për të përmbushur detyrimet ligjore p.sh. nëse një organ shtetëror i autorizuar kërkon të dhëna nga MKT në një procedurë të përcaktuar me ligj ose nëse është e nevojshme të merret një vendim i saktë për një ankesë nga një abonues.

Gjithashtu, ky lloj përpunimi i të dhënave kryhet për përmbushjen e një marrëveshjeje të lidhur ndërmjet MKT-së, siç është ofrimi i shërbimeve të dakorduara ndaj abonuesit ose pagesa e faturave mujore të vonuara. Për shembull - për t'ju njoftuar se një paketë e caktuar do të skadojë ose se një sasi e caktuar komunikacioni është shfrytëzuar, për t'ju informuar për faturën tuaj të papaguar ose për t'ju njoftuar se keni kaluar në roaming, gjegjësisht se telefoni juaj celular është kyçur në një rrjet të huaj.

Në raste të caktuara, MKT i përpunon të dhënat e abonuesve në bazë të interesit legjitim dhe në drejtim të mbrojtjes së përdoruesit nga shpenzimet e panevojshme. Për shembull: - nëse abonuesi kalon në roaming, i kujtojmë atij se ai ka mundësinë të aktivizojë një paketë të caktuar të dedikuar për komunikacionin në roaming, e cila i lejon atij të optimizojë shpenzimet kur i përdor shërbimet jashtë vendit, gjegjësisht në roaming ose duke analizuar sasinë e komunikacionit të realizuar në një kohë të caktuar (gjegjësisht rritjen e shpejtë e sasisë së komunikacionit) dhe informimin e tij me qëllim të mbrojtjes së MKT-së dhe të abonuesit nga mashtrimi, abuzimi ose shfaqja e një faturë tepër të lartë për abonuesin.

7. Si i ruajmë të dhënat e juaja personale?

MKT i ka zbatuar masat e duhura teknike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat personale nga qasja e paautorizuar, zbulimi i paautorizuar ose abuzimi i mundshëm. Punonjësit tanë janë të trajnuar për të punuar në përputhje me dispozitat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale dhe aktet e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe janë të detyruar t'i respektojnë ato. Çdo person që ka qasje në të dhënat tuaja personale është i detyruar të mbrojë konfidencialitetin e të dhënave dhe të veprojë sipas udhëzimeve të MKT-së në përputhje me rregulloret ligjore në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Vetëm personat e autorizuar nga MKT kanë të drejtë të qasen në të dhënat tuaja personale, në masën e nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre të punës ose angazhimit të tyre.

Çdo person i autorizuar që ka qasje në të dhënat tuaja personale nënshkruan një deklaratë që angazhohet për fshehtësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale gjatë përpunimit të tyre.

Të dhënat personale të përpunuara nga MKT ruhen në serverë të vendosur në selinë e MKT-së, por edhe në një server në një shtet anëtar të BE-së, në bazë të një marrëveshje të lidhur.

As MKT, e as përpunuesit nuk do t'i bartin të dhënat tuaja për përdorim nga palë të treta, përveç nëse për këtë kanë pëlqim nga ana e juaja, ekziston obligim ligjor ose në bazë të kontratës së dakorduar me MKT-në.

8. Transferimi i të dhënave personale në vende të huaja

Duke e marrë parasysh që MKT është pjesë e Grupacionit Dojçe Telekom, të dhënat personale të abonuesve mund të transferohen në një nga kompanitë brenda Grupacionit Dojçe Telekom me qëllim të ofrimit të shërbimeve teknike ose burimeve. Gjithashtu, me qëllim të realizimit të një marrëdhënieje të caktuar afariste lidhur me ofrimin e shërbimeve për abonuesit, mund të ndodhë që ne të angazhojmë përpunues të të dhënave personale të vendosura jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (p.sh. prodhues dhe mirëmbajtës të zgjidhjeve softuerike të përdorura nga MKT ose matjen e kënaqësisë së abonuesve, etj.). Gjatë kryerjes së transferimit të të dhënave personale, sigurohet një nivel i lartë i masave teknike dhe organizative për të siguruar fshehtësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale nëpërmjet klauzolave standarde për mbrojtjen e të dhënave personale që janë miratuar nga Komisioni Evropian.

Nëse bartja bëhet në vende jashtë Bashkimit Evropian apo Hapësira Evropiane Ekonomike, bartja do të bëhet vetëm nëse përmbushen kushtet ligjore për lejimin e së njëjtë.

9. Përpunimi i të dhënave personale nga palë të treta

Të gjitha shoqëritë tregtare që janë partnere të MKT-së dhe të cilët në kuadër të angazhimit të tyre dhe marrëdhënieve afariste përpunojnë të dhëna personale nga abonuesit e MKT-së janë të detyruar të zbatojnë masat e duhura teknike dhe organizative që sigurojnë mbrojtjen e të dhënave personale dhe se me cilin partner MKT ka lidhur Marrëveshje përkatëse ku përcaktohet qëllimi dhe mënyra e përpunimit të të dhënave personale, si dhe cilat të dhëna personale mund t'i përpunojë ai partner.

(për shembull – në mënyrë që ne të mund të dorëzojmë produktin që e keni porositur në internet, ose të sigurojmë instalimin e infrastrukturës dhe pajisjeve të nevojshme në shtëpinë tuaj, ose t'ju dorëzojmë faturën mujore, ose t'ju kujtojmë se nuk është paguar, ose për të filluar një procedurë të pagesës së detyruar).

10. Sa gjatë i ruajmë të dhënat tuaja personale?

Të dhënat e juaja personale i ruajmë në afatet e përcaktuara me ligj dhe me aktet tona interne, në periudhë kohore sa është e nevojshme që të përmbushen qëllimet përkatëse.

- Të dhënat personale të abonuesve të cilët janë futur në sistemin e evidentimit të MKT-së në bazë të një marrëveshje të lidhur parapaguese (Shërbime postpejd) ruhen gjatë të gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies abonuese dhe për një periudhë edhe prej një viti nga data e lëshimit të faturës së fundit së abonuesit për shërbimet e ofruara, gjegjësisht ndërprerjen e marrëdhënies parapaguese.
- Të dhënat personale të abonuesve të futura në sistemin e evidentimit të MKT-së bazuar në përdorimin e Shërbimeve pripejd pa lidhur kontratë abonimi ruhen gjatë të gjithë kohëzgjatjes së vlefshmërisë së SIM kartelës dhe një vit nga momenti i çaktivizimit të kartelës SIM.
- Të dhënat për komunikacionin e realizuar ruhen për një periudhë 12 mujore nga data e komunikimit, për të mundësuar disponueshmërinë e këtyre të dhënave për qëllime të parandalimit ose zbulimit të veprave kriminale, për kryerjen e procedimeve penale ose kur e kërkojnë interesat e sigurisë dhe mbrojtjes së Republika e Maqedonisë së Veriut, si dhe për iniciimin e procedurës për pagesën e detyruar të borxhit.
- Të dhënat për faturat e dhëna mujore ruhen në afat prej 10 vitesh pas skadimit të vitit në të cilin janë lëshuar.

Pas skadimit të periudhave të ruajtjes, të dhënat personale fshihen nga evidenca. Në raste të caktuara dhe për lloje të caktuara të dhënash, është e mundur që MKT të anonimizojë të dhënat personale në një nivel që e bën të pamundur lidhjen e të dhënave me çdo abonues ose subjekt të të dhënave personale, me çka ndalon përpunimi i të dhënave personale. Të dhënat e tilla anonime MKT mund t'i përdorë për t'i përgatitur analiza afariste ose për qëllime statistikore (p.sh. për planifikimin e rrjetit, parashikimin e vëllimit të komunikacionit, etj.)

Vërejtje: Ju lutemi ta keni parasysh se edhe krahas përmbushjes së kushteve të lartpërmendura nuk i fshijmë të dhënat e tuaja personale nëse:

- keni borxh të pashlyer në bazë të marrëveshjes parapaguese për të cilën është ngritur procedurë e pagesës së detyrueshme të kërkesave dhe të njëjtat i përpunojmë deri në përfundimin e procedurës për pagesën e borxhit.
- Keni ankesë të shtruar në afatin ligjor, deri në përfundimin final të procedurës pas ankesës në pajtim me rregullat në fuqi.
- udhëheqjen e një lloji tjetër të procedurës gjyqësore, deri në përfundimin e plotfuqishëm të tij.

11. Cilat janë të drejtat e juaja?

Nën kushte të caktuara të përcaktuara me ligj, keni të drejtë qasjeje, korrigjimi, fshirjeje, kufizimi të përpunimit, transferimit të të dhënave tuaja personale, të drejtë ankese, të drejtë për të mos qenë objekt i vendimit të bazuar në përpunimin automatik të të dhënave, të drejtën e tërheqjes së pëlqimit. Këto të drejta tuaja dalin nga LMDHP.

Të drejtë informimi (neni 17 dhe 18 nga LMDHP)	E kemi për obligim t'ju informojmë se të cilat të dhëna i grumbullojmë për ju, për cilat qëllime i përpunojmë, sa gjatë i ruajmë dhe nëse ua zbulojmë palëve të treta.
Të drejtë qasjeje (neni 19 nga LMDHP)	Me kërkesën tuaj, e kemi për obligim t'u japim informacion të detajuar për të dhënat që i përpunojmë për ju. Formulari i Kërkesës për qasje në të dhënat personale është publikuar në këtë link
Të drejtë korrigjimi (neni 20 nga LMDHP)	Me kërkesën tuaj, do t'i korrigjojmë ose plotësojmë të dhënat e juaja të pasakta ose të paplota. Formulari i Kërkesës për korrigjimin e të dhënave personale është publikuar në këtë link
Të drejtë fshirjeje (neni 21 nga LMDHP)	Me kërkesën tuaj, do t'i fshijmë të dhënat: nëse është përmbushur qëllimi për të cilin janë përpunuar; nëse e keni tërhequr pëlqimin për përpunim; nëse të dhënat janë përpunuar në mënyrë të paligjshme; nëse ankoheni për përpunimin ose për shkak të respektimit të obligimit ligjor për fshirjen e të dhënave kur më nuk ekziston bazë ligjore për përpunimin. Formulari i Kërkesës për fshirjen e të dhënave personale është publikuar në këtë link
E drejta e kufizimit të përpunimit (neni 22 nga LMDHP)	Me kërkesën tuaj, do ta kufizojmë përpunimin e të dhënave personale: nëse e kontestoni saktësinë e të dhënave personale, gjatë periudhës derisa nuk e verifikojmë saktësinë e tyre; nëse e konsideroni se përpunimi është i paligjshëm, por e kundërshtoni fshirjen ose nëse ju nevojiten të dhënat për të ushtruar kërkesat ligjore. Formulari i Kërkesës për kufizimin e përpunimit të të dhënave personale është publikuar në këtë link
E drejta për transferimin e të dhënave (neni 24 nga LMDHP)	Me kërkesën tuaj, ne do t'ua transferojmë të dhënat tuaja personale në një format të strukturuar, të përdorur zakonisht dhe të lexueshëm nga makina. Kjo e drejtë zbatohet kur përpunimi i të dhënave personale kryhet në bazë të pëlqimit ose marrëveshjes dhe kur përpunimi kryhet me mjete të automatizuara. Formulari i Kërkesës për transferimin e të dhënave personale është publikuar në këtë link

E drejta e ankesës (neni 25 nga LMDHP)	Në bazë të ankesës tuaj, ne do ta ndalojmë përpunimin e të dhënave nëse baza ligjore për përpunimin e tyre është interesi ynë legjitim ose qëllimet statistikore, me kusht që e drejta juaj për privatësi të mbizotërojë mbi interesat dhe qëllimet tona. Formulari i ankesës është publikuar në link
E drejta e tërheqjes së pëlqimit (neni 11 nga LMDHP)	Kur baza ligjore për përpunimin e të dhënave tuaja personale është pëlqim i dhënë, ne do ta ndalojmë përpunimin e tyre për qëllimet për të cilat është dhënë pëlqimi, nëse i njëjti tërhiqet. Pëlqimet e dhëna mund të tërhiqen në çdo kohë, pa pagesë, nëpërmjet njërit prej kanaleve të përcaktuara në pikën 6.6 të këtij Informacioni. Tërheqja e pëlqimit nuk ndikon në ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale që është kryer në bazë të pëlqimit para tërheqjes së tij. Formulari për Deklaratën për dhënien ose tërheqjen e pëlqimit është publikuar në këtë link.

Makedonski Telekom SHA Shkup do t'ju dërgojë informacion për aktivitetet e ndërmarra në bazë të kërkesës tuaj pa ndonjë vonesë të panevojshme në pajtim me afatet e përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Nëse vlerësoni se përpunimi i të dhënave tuaja personale nga MKT nuk është në përputhje me dispozitat e LMDHP ose vlerësoni se është shkelur ndonjë e drejtë e juaj për mbrojtjen e të dhënave personale, ju keni të drejtë të paraqisni një kërkesë në Agjencinë për mbrojtjen e të dhënave personale si organ kompetent për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së aktiviteteve të ndërmarra gjatë përpunimit të të dhënave personale në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kërkesën mund ta shkarkoni në linkun vijues:

https://www.dzlp.mk/sites/default/files/u4/baranje_za_utvrduvanje_na_prekrshuvanje_na_zzlp.docx

12. Publikimi dhe ndryshimi i Politikës së privatësisë

Kjo Politikë e privatësisë për të dhënat personale MKT mund ta ndryshojë dhe plotësojë, sipas nevojës ose ndryshimit të dispozitave ligjore.

Versioni i vlefshëm i Politikës së privatësisë gjithmonë do të publikohet dhe do të jetë në dispozicion në faqen e internetit të Makedonski Telekom SHA Shkup – telekom.mk.

3. Pjesa përfundimtare

Kjo Politikë hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj dhe do të fillojë të zbatohet pas publikimit të saj në portalin MKT. Kjo do të thotë që versioni i mëparshëm për Politikën e Privatësisë dhe Udhëzuesin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale POL 008, miratuar më 6.12.2024, pushojnë së qeni të vlefshme.

3.1. Referencat

POL 008

Versioni nr. 8

Makedonski Telekom SHA Shkup, të gjitha të drejtat janë të rezervuara

- Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20) dhe Ligji për Ndryshimet në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 294/21)

- LIGJ PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 101 e 21.5.2025)

Miratoi:

Drejtori Kryesor Ekzekutiv

Nikolla Lushev